



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Rron 2019" të datës 15.09.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 11.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pelet" me numër të prokurimit 616-23-6338-1-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Rron 2019" e datës 15.09.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 11.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pelet" me numër të prokurimit 616-23-6338-1-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Rron 2019" si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Rron 2019" (tutje "parashtruesi") me datë 15.09.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 11.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pelet" me numër të prokurimit 616-23-6338-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet kryesore të parashtruesit janë cituar si në vijim:

- I. *"Autoriteti Kontraktues Komuna Prishtinës në aktivitetin e prokurimit -Furnizim me pelet, tek kriteret e perzgjedhjes ka përdorur termin të ngjashme që nuk përmendet në LPP dhe i cili dëmton konkurrencën e OE të cilët veprimtari të rregullt e kanë lëndën e kontratës Furnizim me pelet, me qëllim të favorizimit të OE që merren me furnizim me karburante".*
- II. *"Ne kemi kërkuar qasje ne dokumente e dorëzuara të OE që i është dhënë kontrata dhe kemi gjetur se OE DHF Company nuk i ka dorëzuar kontratat për furnizime të ngjashme (lende djegese) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të këtij Njoftimi për Kontratë jo me pak se 400.000,00, por vetëm listën e kontratave".*
- III. *"Kodi i duhur për furnizim me pelet sipas FPP 20161000-2 dhe është i ndryshëm me kodin e lëndës djegëse për të cilin i janë pranuar OE DHF Company furnizimet e ngjashme në tri vitet e fundit. Rrjedhimisht sipas opinionit të KRPP-së të datës 09.06.2013 si bazë për të përcaktuar termin të ngjashme përdoret edhe FPP. Në rastin konkret për lëndën e kontratës - Furnizim me pelet, FPP është 20161000-2, ndërsa referencat dhe lista e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit të ofruara nga OE DHF Company, kategorizohen në FPP 23000000-7".*

Sa i përket pretendimit të parë (I), parashtruesi këtë pretendim ankimor e ka drejtuar kundër dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Në anën tjetër kërkesa për rishqyrtim është drejtuar kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues. Me fjalë të tjera këtë pretendim parashtruesi këtë pretendim ka pasur mundësi që t'a parashtroj në faza të mëhershme të aktivitetit të prokurimit kundër dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Për këtë arsye ky pretendim është i pabazuar në tërësi. Përndryshe edhe ashtu termi "i ngjashëm" nuk e kufizon asnjëherë konkurrencën por përkundrazi e stimulon atë në kuptim të nenit 6 dhe 7 lidhur me nenet 27 dhe 28 të LPP.

Sa i përket pretendimit të dytë (II), fillimisht duhet cekur se ky pretendim ka të bëjë me kërkesën vijuese të dosjes së tenderit:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe professional 1.Operatori duhet te ofroj dëshmi te mjaftueshme se ka realizuar kontrata për furnizime të ngjashme (lende djegese) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të këtij Njoftimi për Kontratë jo me pak se 400.000,00.	Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje e furnizimeve.
---	-----------	---	---

Nga administrimi i ofertës së tenderuesit të rekomanduar si provë në këtë rast është gjetur se i njëjti ka dorëzuar dëshminë e kërkuar dokumentare "listën e kontratave të realizuara duke plotësuar aneksin 6 të dosjes së tenderit...(në 3 vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë jo më pak se 400,000.00 euro)". Përndryshe nga formulimi i pretendimit mund të konfirmohet se as vet parashtruesi nuk e konteston që tenderuesi i rekomanduar e ka dorëzuar listën e kontratave. Sidoqoftë me datë 18.08.2023 është dërguar një letër standarde për sqarime shtesë për tenderuesin e rekomanduar i cili me datë 28.08.2023 është përgjigjur në këtë kërkesë duke dërguar edhe dokumentet shtesë të kërkuara si dëshmi pikërisht për listën e kontratave sipas kërkesës përkatëse të dosjes së tenderit.

Sa i përket pretendimit i tretë (III), duhet sqaruar se kodi kryesor për këtë aktivitet të prokurimit sipas FPP është 20161000-2 Dru te përpunuara. Referencat dhe listat e kontratave janë të ngjashme me kontratën për të cilën është duke u zhvilluar ky aktivitet i prokurimit duke marrë parasysh edhe kodin kryesor sipas FPP. Prandaj edhe ky pretendim i parashtruesi është i pabazuar.

Sidoqoftë, nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij dhe nuk ka paraqitur fare argumente ose prova për të mbështetur kërkesën e tij për rishqyrtim. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.09.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.